



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 133/9 Prot

Tiranë, më 22/07.2020

V E N D I M

Nr.87, datë 22.07.2020

Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me shkresën nr. 133/4, datë 10.06.2020, në lidhje me procedurën e ristrukturimit të institucionit Bashkia Pogradec

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë prej Presidentit të Republikës, në lidhje me pretendimet për 133/4, datë 10.06.2020, në lidhje me parregullsi të lejuara gjatë procesit të ristrukturimit në Bashkinë Pogradec,

VËREJ SE:

Në informacionin e përcjellë përpara Komisionerit, ngrihet pretendimi se gjatë ristrukturimeve të mëpasshme dhe ndryshimeve në strukturë, janë bërë emërimet e reja në institucion pa marrë parasysh kriteret dhe kushtet e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Komisioneri, pasi mori dijeni për pretendimet mbi problematikën e paraqitur me shkresën nr. 133/4, datë 10.06.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 133/5 prot., datë 19.06.2020 *“Njoftim mbi fillimin e verifikimit të informacionit të regjistruar me nr. 133/4, datë 10.06.2020, në lidhje me procedurën e ristrukturimit të institucionit Bashkia Pogradec”*, filloi verifikimin duke kërkuar aktet administrative nga institucioni.

Po kështu, në vijim të këtij procesi, në datën 20.07.2020, u zhvillua edhe një seancë dëgjimore “online”, me përfaqësuesit e institucionit të Bashkisë Pogradec, ku u diskutua në lidhje me situatën e krijuar pas ristrukturimit të institucionit.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e akteve administrative të cilat pasqyrojnë procesin e ristrukturimit të institucionit, konstatohet që Bashkia Pogradec ka kaluar në disa ndryshime dhe ristrukturime, të cilat kanë passjellë ndryshime të pozicioneve të punës në lidhje me marrëdhënien e tyre me shërbimin civil.

Me miratimin e strukturës së re, organizimi i institucionit ka ndryshuar. Konstatohet që, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 51, datë 14.02.2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, njësive administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2020” (e ndryshuar me vendimin nr.141, datë 17.06.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 51, datë 14.02.2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, njësive administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2020”), është miratuar struktura e vitit 2020, e cila ka sjellë të tjera ndryshime në organizimin dhe funksionimin e institucionit të bashkisë, rrjedhimisht edhe në “Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore”, struktura e së cilës ka kaluar nga **21** pozicione pune në strukturën e vitit 2019, në **26** të tilla në strukturën e vitit 2020.

Duke analizuar strukturën e fundit, rezultoi se pozicionet e punës për të cilat pretendohet se është lejuar shkelje gjatë plotësimit të tyre, janë pozicione pune në “Njësinë e Menaxhimit të Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave”, detyrat e së cilës janë procese të njësive publike direkte të shërbimit, që nuk rregullohen nga ligji për shërbimin civil. Bëhet fjalë për disa pozicione pune, të cilat kryejnë funksione ndihmëse administrative në drejtim të grumbullimit të të ardhurave në subjekte.

Nga sa u parashtrua më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, si dhe nga përfundimet e arritura pas takimit “on line” të zhvilluar me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se procedura e ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimet organizative gjatë këtij procesi, janë kryer në përputhje kërkesat e ligjit nr. 152//2014 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij dhe nuk ka raste të emërimeve të reja të nëpunësve civilë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores,

“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 133/4, datë 10.06.2020, pasi nuk u konstatuan parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës së ristrukturimit të institucionit Bashkia Pogradec.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucionit Bashkia Pogradec dhe ankuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Konceptoi: Zamira Mujali, inspektor i KMSHC

Pranoi: Ilia Kukumi, Drejtor i IHA

Miratoi: Arbana Basha, Drejtor i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit